


16.01.2009

6 KOSOVA SOT



GARA BALLKANIKE, STUDENTËT KOSOVARË SFIDOHEN NË AUSTRI

Studentët kosovarë do të sfidohen për dije në Austri në muajin korrik, të këtij viti, në projektin "Ballkan Case Challenge" (Rasti sfidues i Ballkanit), i cili do të organizohet nga Vusi austriak. Në sfidimin ballkanik do të marrin pjesë shtetet e Evropës Juglindore, si dhe vetë nikoqirja Austria. But Dedaj, udhëheqësi i zyrës së Vus Austria në Prishtinë, në një konferencë shtypi të mbajtur të martën në Prishtinë, ka pohuar se kjo është fazë e re dhe shumë e rëndësishme për studentët kosovarë dhe në përgjithësi për rajonin, sepse krijon mundësi që të shkëmbehen përvojat dhe dituritë që i kanë fituar studentët në institucionet arsimore, gjegjësisht në universitet. "Aplikuesit duhet të jenë studentë të universiteteve, vlen edhe për bachelorët dhe masterët, dhe ata duhet që të njohin gjuhën angleze, por edhe njohja e gjuhës gjermane është përparësi", ka thënë ai.

Gara ballkanike nga Kosova këtë viti do të zgjedhë 12 studentë nga fusha e biznesit, drejtësisë, teknikës dhe modelit të Këshillit Evropian. Dedaj ka thënë se projekti mundëson hapjen e perspektivave të reja studentëve të shkëlqyer të arsimit të lartë të Kosovës. "Projekti 'Ballkan Case Challenge' është një mjet i qëndrueshëm për lidhjen e arsimit të lartë dhe punësimit në Evropën Juglindore dhe se pjesëmarrësit mund të dëshmojnë se Ballkani është për integrim", është shprehur ai. Koordinatorja e projektit ka thënë se ka shumë interesim për këtë projekt dhe se pritet që të ketë edhe më shumë interesim duke e marrë parasysh se afati për aplikim është deri më 15 shkurt. "Ne do t'i përzgjedhim 50 studentë për garë, kurse 12 do të përzgjidhen për garën në Vjenë dhe kjo është një mundësi e mirë për fituesit", ka thënë ajo. Projekti financohet nga Agjencia Austriake i Bashkëpunimit dhe partnerë të tjerë vendës e ndërkombëtar. Në vitin e kaluar në këtë garë të mbajtur në Vjenë studentët e Universitetit të Prishtinës, nga 4 disiplina, në tri kanë dalë fitues. Arta Bucaliu, studente e UP-së, shprehet se kjo është një mundësi e mirë që ne si universitet të dëshmojmë veten. "Duhet të studiojmë shumë që ta dëshmojmë punën tonë se e meritojmë shtetin që e kemi fituar dhe kjo bëhet më dije", ka theksuar ajo.

A. BELA

N DY

igjit për koncesione

5 KOSOVA SOT